



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Nr. 580/3 Prot

Tiranë, më 15.10.2020

**V E N D I M**

Nr.122, datë 15.10.2020

**“Mbi përfundimin e procedimit administrativ filluar në bazë të informacionit të përcjellë me kërkesën nr. 580, datë 2.7.2020, të nëpunësit \*\*\*\*\* , në lidhje me pretendimet për parregullsi gjatë procesit të ristrukturimit”**

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në pikën 1, të nenit 11, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, nenin 90, të ligjit nr.44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, si dhe Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.3.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, pas shqyrtimit të materialit të përgatitur dhe propozimit të paraqitur prej Drejtorisë së Përgjithshme të Inspektimit dhe Mbikëqyrjes, në përfundim të verifikimit të informacionit të përcjellë nëpërmjet kërkesës së nëpunësit \*\*\*\*\* ,

**VËREJ SE:**

Nëpërmjet një kërkesë të dërguar në mënyrë elektronike pranë Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, nëpunësi \*\*\*\*\* , ka ngritur pretendimin se, pas ristrukturimit të institucionit, organika e re ka parashikuar 4 pozicione për inspektorë në Sektorin e Ujërave ku ai punonte më parë dhe megjithëse gëzonte statusin e nëpunësit civil, pa të drejtë, Komisioni i Ristrukturimit dhe njësia përgjegjëse, nuk e kanë sistemuar atë në asnjë nga këto pozicione.

Nga verifikimi administrativ i kryer nga Komisioneri, rezulton se, nëpunësi \*\*\*\*\* , është nëpunës civil, i cili ka kryer detyrën, “Inspektor në Sektorin e Inspektimit të Ujërave”, Dega Rajonale Fier, pranë ISHMPUT, transferuar në këtë pozicion për shkak të ristrukturimit të mëparshëm, me aktin nr. 6770/21, datë 21.9.2018, të Departamentit të

Administratës Publike (të dhëna këto, nxjerrë nga Raporti Përfundimtar i Mbikëqyrjes të kryer pranë Inspektoratit Shtetëror të Mjedisit, Pyjeve, Ujërave dhe Turizmit, i cili ka përfunduar me vendimin paralajmërues nr. 88, datë 30.7.2019, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil).

Për shkak të shkrirjes të ISHMPUT dhe krijimit të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit me Vendimin nr. 568, datë 17.7.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për krijimin, mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit”, në këtë institucion është kryer procesi i ristrukturimit sipas kërkesave që përcakton ligji nr.152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe akteve nënligjore në lidhje me ristrukturimin.

Komisioni i Ristrukturimit i ngritur në këtë rast, pasi ka shqyrtuar mundësinë e sistemimit të çdo nëpunësi civil në vendet e lira ekzistuese, e ka vlerësuar të pamundur sistemimin e nëpunësit \*\*\*\*\* në strukturën e re të AMT-së, për shkak se profili i tij arsimor nuk përputhej me asnjë prej pozicioneve të punës.

Duke e konsideruar të padrejtë këtë qëndrim të Komisionit të Ristrukturimit, ai i është drejtuar menjëherë, nëpërmjet postës elektronike, Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, për të ndërhyrë në lidhje me sistemimin e tij në vendin e mëparshëm të punës apo në ndonjë vend tjetër të lirë, të të njëjtës kategori.

Ndërkohë, gjatë procesit të hetimit administrativ të këtij rasti, Komisioneri, u vu në dijeni të faktit se, për të gjithë nëpunësit e mbetur të pasistemuar, Komisioni i Ristrukturimit, ka rishqyrtuar mundësinë e sistemimit të tyre, fillimisht në Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit dhe institucionet e varësisë, dhe më pas, në institucione të tjera të administratës shtetërore, sipas listës së pozicioneve vakante të vëna në dispozicion nga Departamenti i Administratës Publike (materiallet janë dërguar në adresën elektronike zyrtare të KMSHC nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit).

Në rastin konkret, sipas Vendimit nr. 4619 prot., datë 10.9.2020, Komisioni i Ristrukturimit, ka vendosur t’i propozojë Departamentit të Administratës Publike (DAP), në cilësinë e njësisë përgjegjëse, transferimin e përhershëm të nëpunësit \*\*\*\*\* në pozicionin “Specialist në Qendrën e Mbrojtjes Civile për Qarqet Fier, Vlorë dhe Gjirokastrë me Qendër në Fier”, në Agjencinë Kombëtare të Mbrojtjes Civile.

Pasi ka shqyrtuar propozimet e komisionit të ristrukturimit, DAP, me vendimin nr.4193/8, datë 14.9.2020, ka pranuar propozimin, duke vendosur transferimin e përhershëm të nëpunësit \*\*\*\*\* në pozicionin “Specialist në Qendrën e Mbrojtjes Civile për Qarqet Fier, Vlorë dhe Gjirokastrë me Qendër në Fier”, në Agjencinë Kombëtare të Mbrojtjes Civile, pozicion të cilin ai e ka pranuar dhe ka shprehur dakordësinë (akt datë 16.9.2020).

Nga sa është parashtruar më sipër, në analizë të dokumentacionit të administruar, Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, arrin në përfundimin se, Komisioni i Ristrukturimit dhe njësia përgjegjëse, kanë vepruar në përputhje me kërkesat e legjislacionit të shërbimit civil duke i dhënë zgjidhje përfundimtare mosmarrëveshjes, prandaj vlerësohet që nuk është e nevojshme për të vijuar më tej procesi i hetimit administrativ të këtij rasti dhe çështja duhet të arkivohet .

### **Për këto arsye:**

Në mbështetje të kompetencës së përcaktuar në nenin 11, pika 1, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, në ligjin nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, si dhe në nenin 34, pika 1, të Rregullores, “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.3.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

### **VENDOSA:**

1. Përfundimin e procedimit administrativ filluar në bazë të kërkesës nr. 580 prot., datë 2.7.2020, të nëpunësit \*\*\*\*\*, në lidhje me pretendimet për parregullsi gjatë procesit të ristrukturimit të kryer në Inspektoratin Shtetëror të Mjedisit, Pyjeve, Ujërave dhe Turizmit dhe arkivimin e çështjes.
2. Të njoftohet për këtë vendim nëpunësi \*\*\*\*\* , Ministria e Turizmit dhe Mjedisit dhe Departamenti i Administratës Publike.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KOMISIONERI**

**Pranvera Strakosha**